



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.01.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.01.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**PRO MEDICAL SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “**Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**”, Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “**PRO MEDICAL SH.P.K.**”, e dt.05.01.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**”, Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-055-121., kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK – së, të datës 30.12.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 30.12.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Ar sy e t i m

Me dt.05.01.2022, Operatori Ekonomik "PRO MEDICAL SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **Ri Tender Blerja e aparaturave mjekësore (KPSH, stomatologji dhe laborator) dhe jo mjekësore**", Nr. i prokurimit- 632-21-8240-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-21-055-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 13.01.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

-Pas konsultave me personelin e KPSH-së, Njësia e kërkesës ka ardhë ne përfundim që specifikacioni duhet te përmirësohet si vijon:

1. Për shkak se shefi i stomatologjisë nuk ka pas aprovim nga Drejtori i DSHMS-se për hapjen e një sektori te ri kirurgjikal i cili shkel statusin e KPSH-se nuk mund te blihen këto pajisje.
2. Loti I -pika 8,9 e 10 nuk hynë nga blerjet me mjete te destinuara për investime kapitale , te njëjtat mund te blihen si barna emergjente nga mallrat dhe shërbimet.
3. Loti II - pika 1,5,6,7,8,9,10,11 e 12 nuk blihen nga mjetet e destinuara për investime kapitale, te njëjtat(uniforma pune) duhet te blihen nga mallrat dhe shërbimet. po ashtu edhe pika 3 është material shpenzues i cili duhet te sigurohet nga mallrat dhe shërbimet.
4. Specifikacioni i blerjes se pajisjeve mjekësore për laborator biokimik-hematologjik nuk mund te blihet nga investimet kapitale sepse blerja e reagensëve duhet te sigurohen nga mallrat dhe shërbimet me ç' rast kërkohet qe edhe pajisjet te sigurohen nga kompania e cila bene furnizimin me reagensa gjë qe kjo blerje po ashtu behet nga mallrat dhe shërbimet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës